



REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. 2-D/DPK Nr. Prot. 01-3021/13 Nr. Prot. 01-3021/13 Data 27-09-2013 Nr. Strana 02 Nr. Daje	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	25.09.2013
REFERENC-Ë:	AKK-DPK- 2771/13
PËR/ZA/TO:	z. Fehmi Mehmeti , Anëtar i Bordit të Drejtoreve ne KRM “Uniteti” - Mitrovicë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	z.Hasan Pretni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion

I nderuari z. Mehmeti,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 pika 12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1 pika 5 dhe 1. 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë :

Opinion

Bazuar ne kërkesën tuja drejtuar Agjencies kundër Korrupsionit të dates 02.09.2013, per tju sqaruar gjendjen e mundshme të konfliktit te interesit ne ushtrimin e funksionit publik ne poziten tuaj te zgjedhur si Zëvendës Guvernator i Bankës Qendrore të Republikës se Kosovës dhe angazhimit tuaj aktual si anëtar i Bordit të Drejtoreve ne KRM “Uniteti “ne Mitrovic. ju njoftojmë se: Pozitat e lartë përmendura, hyn ne listen e zyrtarve te lartë publike te paraparë sipas nenit 4 te ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit te Interesit ne Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Ushtrimi I këtyre dy funksioneve publike ne te njëjtën kohë paraqet mos pajtueshmëri dhe kufzim ne ushtrim te funksionit publik të paraparë sipas nenit 16.1 te ligjit Nr.04/L-051 Për Parandalimin e Konfliktit te Interesit ne Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Institucioni i Bankës Qendrore i Republikës së Kosovës ku ju do të ushtroni pozitën e Zëvendës Guvernatorit e ka të rregulluar çështjen që lidhet me Konfliktin e Interesit, dhe detyrat e anëtareve të organeve vendimmarrëse dhe personelit të Bankës Qendrore, me ligjin Nr. 03/L-209 Nenin 69.3 ku thuhet:

Guvernatori dhe Zëvendësguvernatorët do të realizojnë detyrat e tyre me orar të plotë. Asnjë nga anëtarët e Bordit Ekzekutiv nuk do të angazhohet në ndonjë punë tjetër, qoftë fitimprurëse ose jo, përveç në ato raste të jashtëzakonshme kur Bordi i Bankës Qendrore lejon një përjashtim nga ky kufizim. Neni 69.3 3 ligjit Nr. 03/L-209.

Andaj ushtrimi i këtyre dy pozitave do të ishte shkelje e parimeve të zyrta të lartë të parapara sipas nenit 7 pika 1.2.3.4.5.6.7.8.9 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin shpresojmë që opinioni ynë do ju ndihmojë në qartësimin e çështjes së ngritur nga ju, dhe presimi nga ana juaj të zbatohen në përpikëri ligjet në fuqi.

Me respekt!

